



VENDIM

Nr. 71 Datë 09.08.2011

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT
TË SHOQËRISË “DITEKO” SH.P.K PËR KUALIFIKIMIN E
IMPIANTIT PRODHUES PËR “HEC-ET NE LUMIN ZALLI I
OKSHTUNIT” : HEC-ET “BOROVE”, “ZABZUN”, “SEBISHT”,
“PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”,
“TERNOVE”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE
“GJORICE” SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 21 datë 18.03.2009, dhe neneve 6, 7 pikat 1 e 2 dhe nenit 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 09.08.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DITEKO” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC-ET “BOROVE”, “ZABZUN”, “SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVE”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICE” si burim i rinovueshem energjie,

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “DITEKO” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, germa a,b,c,d**
Pershkrimi i pergjithshem i centralit.
Ky dokumentacion eshte dhene i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, germa a,b,c,d**
Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e pergjithshme, skema funksionale etj.
Ky dokumentacion eshte paraqitur ne menyre korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DITEKO” sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC-ET “BOROVE”, “ZABZUN”, “SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVE”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICE” si burim i rinovueshem energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI